

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria**

(zgjidhjet)

P10

Data 25/07/2020

Detyra 1

(a) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën Beri-Audit, përgjegjës për auditimin e Elkofar, kompani që prodhon pllaka elektronike dhe i shet tek prodhuesit e panelëve të energjisë diellore. Kjo është hera e parë që po menaxhoni një klient të auditimit, pasi që keni marr detyrën nga Mic Boletini, menaxheri i mëparshëm. Planifikimi i auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 është duke filluar dhe Aurora L. është partnere e auditimit (auditore e angazhimit) të Elkofar. Tash së voni jeni takuar me Arben Istrefin, drejtor financiar i kompanisë Elkofar dhe keni marr shënimet e mëposhtme:

Komentet e Arben Istrefit gjatë takimit tuaj:

Vështrim i përgjithshëm mbi kompaninë

Aktiviteti kryesor i biznesit të Elkofar mbetet prodhimi i pllakave elektronike. Njëri nga materialet kyçe që përdoret në prodhimin e pllakave janë telat e bakrit të cilat importohen. Si një masë për zvogëlimin e kostove, në maj të vitit 2019, është nënshkruar një kontratë me një furnitor jashtë vendit dhe tani të gjitha kabllo të bakrit importohen sipas kësaj kontrate të furnizimit. Blerjet bëhen me valutë të huaj, por kompania nuk përdor kontrata foruad (për fiksimin e çmimit dhe datës) lidhur me këto importe. Elkofar ka dy fabrika të prodhimit, njëra prodhon produkte për eksport ndërsa tjetra për tregun vendor. Rreth gjysma e produkteve të kompanisë eksportohen, mirëpo tregu i eksportit është duke u ballafaquar me vështirësi për shkak të konkurrencës nga prodhues të lirë nga jashtë. Shumica e shitjeve vendore bëhen përmes kontratave me rreth 20 konsumatorë.

Zhvillimet e fundit

Në fillim të dhejtorit 2019, fabrika që prodhon për tregun vendor kishte ndërprerë prodhimin për një javë. Një numër i konsumatorëve kishin kthyer mallrat, duke u ankuar se kishte defekte në pllakat elektronike. Gjatë inspektimit, është zbuluar se bakri që përdoret në pllaka elektronike është ndryshkur prandaj nuk mund të përdoret. Ky ndryshk është vështirë për tu vërejtur pasi që nuk mund të shihet me sy prandaj mbështeten në testim elektrik. Të gjithë konsumatorët janë kontaktuar menjëherë dhe nëse ishte e nevojshme produktet janë tërhequr dhe zëvendësuar. Bakri i ndryshkur që ka mbetur në stoqe është identifikuar dhe është ndarë nga bakri tjetër. Së voni ka filluar linja e re e prodhimit e cila do të sigurojë se kompania përmbushë kërkesat e reja rregullatore që ndalon përdorimin e disa kimikateve, e cila rregullore hyn në fuqi në shkurt të vitit 2020. Në qershor 2019, është negociuar një hua nga banka prej €30 milion me një interes 4%. Qëllimi kryesor i kredisë ishte financimi i shpenzimeve kapitale të nevojshme për linjën e re të prodhimit. €2.5 milion e huasë përfaqëson një mbiterheqje e cila ishte konvertuar në financim afatgjatë.

Çështje tjera

Disa nga drejtorët ekzekutiv të Elkofar si dhe shefi i kontabilitetit kanë ikur nga kompani në shtator 2019, për të themeluar një kompani të specializuar në riciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike. Kjo kompani e re nuk konsiderohet konkurrencë e Elkofar. Drejtorët u larguan në mënyrë miqësore nga kompania dhe ndërkohë Elkofar kishte rekrutuar drejtorët tjerë për të zëvendësuar këto pozita. Njëri nga menaxherët e auditimit të Beri-Audit, Mic Boletini, është duke u intervistuar nga kompania Elkofar për pozitën e shefit të kontabilitetit. Mici është kandidat i mirë për këtë pozitë pasi që ka zhvilluar njohuri të mirë për Elkofar gjatë kryerjes së punës si menaxher i auditimit në vitin e kaluar. Në takimin e fundit të bordit të Elkofar është diskutuar tarifa e auditimit. Anëtarët e bordit shprehën shqetësimin e tyre për tarifën e lartë të auditimit duke konsideruar humbjen e kompanisë këtë vit. Anëtarët e bordit janë të interesuar të dinë nëse auditimi mund të kryhet duke u bazuar në tarifa kontingjente.

Informatat financiare të ofruar nga kompania të pasqyrës së ta ardhurave draft për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019

	2019 draft '000	2018 aktuale '000
Të hyra	12,500	13,800
Kosto operative	(12,000)	12,800
Fitimi operativ	500	1,000
Kosto financiare	(800)	(800)
Fitimi/(humbja) e vitit	(300)	200

Drafti i pasqyrës së pozicionit financiar nuk është përgatitur ende por Arbeni thekson se pasuria gjithsej me 31 dhjetor është €180 milion dhe paraja në bankë është €130,000. Bazuar në shifrat draft, koeficienti qarkullues është 1.1 dhe koeficienti i shpejtësisë është 0.8.

Kërkohet:

- (i) Vlerësoni rreziqet e binzesit me të cilat ballafaqohet Elkofar; (12 pikë)
- (ii) Identifikoni dhe shpjegoni KATËR rreziqe të anomalive materiale që duhet të konsiderohen gjatë planifikimit të auditimit; dhe (8 pikë)
- (iii) Diskutoni çështjet etike dhe rekomandoni veprimet e duhura që duhet të ndërmerren nga firma e auditimit. (10 pikë)

(Total: 30 pikë)

Zgjidhja

(i) Rreziqet biznesore

Mallrat e importuara – luhatjet në këmbimet valutore

Elkofar mbështetet në përbërës të prodhimit që importohen nga jashtë. Kjo e ekspozon kompaninë ndaj luhatjes së çmimieve për shkak të normës së këmbimit valutor. Kompania nuk përdor kontrata forward për të zvogëluar këtë rrezik që mund të mos jetë strategji e mençur për një biznes që mbështetet në import. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor po ashtu mund të shkaktojnë luhatjen në fitimin e kompanisë.

Mallrat e importuara – çështjet me transportin

Mbështetja e madhe në import do të thotë edhe rritje të kostonë së transportit. Gjithashtu mund të ketë pengesa në probleme me avionë. Si rezultat mund të ketë mungesë të stokeve një kohë dhe kështu pengesa në prodhim. Përveç nëse kompania mban nivel të arsyeshëm të stokeve për të adresuar vështirësitë me transportin, kjo mund të shkaktojë problem me reputacionin.

Mbështetja në një furnitor të vetëm

I gjithë teli i bakrin vjen nga një furnitor jashtë vendit. Ky nivel i mbështetjes është tepër me rrezik dhe çfardo pengese nga ana e furnitorit do të reflektohet edhe në kompaninë Lenjani.

Çështjet me kontrollin e cilësisë

Që nga përzgjedhja e furnitorit, kompania është duke u ballafaquar me cilësi të dobët të telave të bakrit që mund të rezultojë me humbjen e konsumatorëve. Ndryshimi i furnitorit mund të ketë qënë rezultat i zvogëlimit të kostove, mirëpo zgjidhja e problemit të cilësisë mund të jetë më problematike për shkak të largësisë me furnitorin. Mund të ketë kosto shtesë për të siguruar cilësinë e duhur psh kosto e testimit shtesë. Marzha operative e kompanisë tashmë është mjaft e ulët vetëm 4% (2014 – 7.2%), prandaj kosto shtesë do ta zvogëlojë këtë marzhë edhe më tutje.

Teknologjia e lartë dhe konkurrenca e madhe

Elkofar shet në një industri me teknologji të lartë, duke konsideruar se pasijet e tilla shumë shpejtë zhvillohet. Ka mundësi që kompania ka nevojë të adaptohet shumë shpejtë me kërkesat në rritje të tregut, por mund të mos ketë burime për të adresuar këtë. Po ashtu Elkofar operon në një industri shumë konkurruese dhe shumë furnitorë mund të ndjekin konsumatorët e njëjtë që do të

thotë se ka presion mbi çmimet. Siç u diskutua më sipër marzha operative e kompanisë është tashmë e ulët dhe zbritja në çmime mund të shkaktojë probleme të mëtutjeshme.

Mbështetja në konsumatorët kyç

Elkofar mbështet në vetëm 20 konsumator për të gjeneruar të hyra nga tregu vendor i cili treg gjeneron rreth 50% të të hyrave të kompanisë. Në një treg konkurrues, do të jetë e vështirë mbajtja e konsumatorëve pa i zbritur çmimet, që do të bëjnë presion të mëtutjeshëm në fitim. Çështja tjetër është se problemi me cilësinë tashmë mund të ketë shkaktuar ikjen e ndonjërit prej konsumatorëve pavarësisht veprimin e kompanisë për të zëvendësuar produktet.

Çështjet rregullatore

Rregullativa e re hyn në fuqi pas disa muajsh. Duket se fabrikat momentalisht nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore prandaj ka filluar ndërtimi i vijave të prodhimit që do të jenë në pajtueshmëri. Kjo çështje shkakton rrezik domethënës të pajtueshmërisë që mund të qooj drejt hetimit nga agjencitë rregullatore dhe mund të rezultoj me gjoba e dënime si dhe reputacion te keq. Gjithashtu ka kosto shtesë të monitorimit dhe kosto për shpenzime kapitale.

Financimi shtesë – çështje me likuiditetin

Është marrë një kredi që përfaqëson 16.7% të pasurive gjatë vitit. Kjo është një shumë materiale që do të rrisë leverazhin e kompanisë dhe rritje të obligimit për të paguar interesin që është 1.2 milion në vit si dhe ripagesa e kredisë në të ardhmen. Kompania nuk duket se ka shumë para, me vetëm €130,000 para të gatshme dhe një mbitëheqje prej €2.5 milion, kapitali punues mund të jetë problem afatgjatë i kompanisë. Koeficienti qarkullues dhe i shpejtësisë po ashtu tregojnë se kompania ka problem në kthimin e borxheve me kohë.

Profitabiliteti

Pasqyra drat e të ardhurave tregon se të hyrat kanë rënë me 9.4% dhe fitimi operativ ka rënë me 50%. Në përgjithësi kompania ka gjeneruar humbje për vitin actual. Në vitin 2015 kostot financiare nuk janë mbuluar nga fitimi operativ dhe duket se këto kosto ende nuk përfshijnë interesin e kredisë së re të cilat do të jenë €500,000 ($€30m \times 4\% \times 5/12$). Përfshirja e koston shtesë do të rrisë humbjen në €800,000. Ky mund të jetë tregues për problem me vijimësinë.

Ndrrimet në menaxhmentin kyç

Humbja e disa drejtorëve gjatë vitit është rrezik biznesor dhe kompania mund të humb aftësitë kryesore dhe përvojën. Mund të merr kohë deri sa drejtorët të zëvendësohen.

(ii) Rreziqet e anomalive materiale

Transaksionet në valutë të huaj – njohja fillestare

Shumica e bakrit importohet që çon në rrezik të trajtimi kontaël për transaksionet me valutë të huaj. Sipas SNK 21 Efektet e ndryshimeve në normat e këmbimit valutro, valuta e huaj në fillim duhet të njihet duke përdorur normën e datës së transaksionit ose normën mesatare nëse valuta nuk luhet në mënyrë domethënëse. Nëse kompania nuk përdorë këtë normë si duhet, kjo mund të shkaktojë shpenzime të pasakta, detyrime dhe stoqe të pasakta.

Transaksionet në valutë të huaj – fitimi dhe humbja nga këmbimi

Një rrezik tjetër është trajtimi kontabël i saldove në valutë të huaj në fund të vitit. Të pagueshmet në valutë të huaj duhet të ripërkthehen në fund të vitit sipas valutës në fund të vitit dhe duke njohur çfardo fitimi ose humbje nga transaksioni. Rreziku është se nëse ky ripërkthim nuk ndodhë në fund të vitit, mund të shkaktoj nën/mbi vlerësim të lloarive të pagueshme dhe shpenzimeve operative. Gjithashtu pagesat që janë bërë gjatë vitit nëse nuk janë përkthyer si duhet mund të shkaktojnë gabime në fitim dhe humbje nga këmbimi valuator.

Tërheqja e produkteve – stoqet e dala jashtë përdorimit

Ekziston një sasi e bakrit që duhet të sjellet në vlerën e saj të neto të realizueshme për shkak të ndryshkut dhe nuk mund të përdoret në pllaka elektronike. Stoqet duhet të vlerësohen sipas SNK 2, matja sipas koston ose VNR cilado që është më e ulët. Nëse stoqet nuk sjellen në VNR atëherë atom und të jenë të mbivlerësuar në fund të vitit. Rreziku rritet edhe më tutje për shkak të pamundësisë së kompanisë të vërej me sy dëmtimet e bakrit por vetëm përmes testimit elektrik.

Tërheqja e produkteve – rimbursimi i konsumatorëve

Për shkak të produkteve të dëmtuara ka gjasë që disa konsumatorë të kërkojnë rimbursim të pagesave në vend të zëvendësimit të produktit. Nëse pagesa është kryer, kompania duhet të njej një provizion për vlerën e rimbursimit. Nëse konsumatori nuk ka paguar ende për mallrat e dëmtuara, atëherë saldoja e llogarisë së arkëtueshme tea ta konsumatorë duhet të shlyhet. Varësisht a ka paguar apo jo konsumatori gabimet në trajtimin kontabël të këtyre rimbursimeve mund të shkaktojnë mbivlerësim të fitimeve në fund.

Financimi shtesë – kapitalizimi i vijës së re të prodhimit

Procesi i ri i prodhimit duket të jetë një shpenzim domethënës capital dhe është me rëndësi që kompania ta trajtojë atë në pajtueshmëri me SNK 16 Prona, impinatet dhe pajisjet si dhe SNK 32 Kosto e huamarrjes. Kosto financiare që shpërndahet direkt në këto makineri duhet të kapitalizohet përgjatë periudhës së ndërtimit të linjës së prodhimit dhe nëse nuk kapitalizohet atëherë pasuria joqarkulluese mund të jetë nënvlerësuar. Po ashtu ka rrezik që për shkak të presionit të fitimit, kompania të nënvlerësojë shpenzimet, kjo do të arrihej përmes trajtimit të zërave të shpenzimit si zëra capital dhe kështu të mbivlerësohet fitimi.

Rregulloret e reja – vlerësimi i fabrikave dhe vijave të prodhimit ekzistuese

Ka rrezik që vijat ekzistuese të prodhimit të jenë dëmtuar (humbje në vlerë). Për shkak të rregullores së re këto vija të prodhimit nuk do të përdoren prandaj kompania duhet të trajtojë ato në pajtueshmëri me SNK 36 Dëmtimi i pasurive. Sipas këtij standardi kompania duhet të ndërmerr rishikime për dëmtimet e mundshme dhe të identifikoj shumën e rikuperueshme. Nëse nuk bëhet ky rishikim, pasuria mund të jetë e mbivlerësuar.

Financimi shtesë – matja dhe shpalosja e kredisë

Kredia e marr nga banka është një detyrim financiar i cili duhet të matet sipas SNRF 9 Instrumentat Financiar, i cili thekson se detyrimet financiare duhet të klasifikohen dhe maten sipas koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv (përveç nëse është vendosur më parë të përdoret vlera e drejtë). Ka rrezik që kosto e amrtizimit nuk është aplikuar që do të thotë se kosto financiare nuk është paraqitur si akruale. Fakti që kosto financiare në draft pasqyrat financiare ka mbetur e njëjtë nga viti i kaluar do të thotë se ka nënvlerësim të koston financiare dhe detyrimeve. Po ashtu ka rrezik që shpalosjet nuk janë bërë sipas SNRF 7 Instrumentat financiar: Shpalosjet. Shënimet e pasqyrave financiare duhet të përmbajnë shpalosje narrative dhe numerime lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut dhe duke marr parasysh materialitetin e kredise, ka mundësi që një shpalosje e tillë të jetë e nevojshme.

(iii) Çështjet etike

Menaxheri i auditimit të firmës Beri-Audit është duke u intervistuar për pozitën e shefit të kontabilitetit në Elkofar.

Kjo çështje krijon kërcënim ndaj pavarësisë. Sipas Kodit të Etikës së IFAC, familjariteti ose frikësimi mund të krijohen me rastin e punësimit te klienti i auditimit.

Kërcënimi i familjaritetit shkaktohet nga marrëdhënia e menaxherit të auditimit me kompaninë. Kjo mund të shkaktojë që ekipi i auditimit të humb objektivitetin, dështoj të sfidojë atë dhe të humb skepticizmin profesional. Gjithashtu anëtarët më të ri të ekipit të auditimit mund të frikësohen nga menaxheri. Ai gjithashtu është në dijeni për metodologjinë dhe procedurat e auditimit që janë zbatuar nga auditimet e mëparshme, që e bën më të lehtë ti anashkalojë ato procedura nëse përdoren edhe këtë vit.

Firma e auditimit duhet të sigurojë se menaxheri i auditimit të mbahet larg angazhimit për auditim te Elkofar dhe gjithashtu të mbahet larg nga aktivitetet binzesore tjera të firmës. Nëse menaxheri ende do të jetë afër aktiviteteve të firmës atëherë kërcënimi i pavarësisë është tepër i madh dhe do të jetë e vështirë të zvogëlohet me masa tjera mbrojtëse.

Çfardo pune që është kryer nga menaxheri i auditimit duhet të rishikohet pasi që mund të ketë kërcënim të vet-rishikimit. Pasi që planifikimit nuk është kryer ende, firma duhet të ketë kujdes që të zbatojë procedura të duhura të kontrollit të cilësisë.

Përfundimi

Auditimi i Elkofar duhet të konsiderohet si auditim me rrezik të lart për shkak të një numri të konsiderueshëm të rreziqeve biznesore dhe rreziqeve të anomalive materiale. Duhet të zhvillohet një strategji e auditimit për të zvogëluar rrezikun e përgjithshëm të auditimit si dhe duhet të respektohen procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë tërë auditimit. Përveç kësaj, çështja etike e menaxherit të auditimit duhet të paraqitet tek partneri i etikës së firmës sa më parë të jetë e mundshme.

Detyra 2

Ju jeni menaxheri i auditimit, përgjegjës për auditimin e klientit Thumanë Shpk, një kompani prodhuese e elementeve të ndryshme të çelikut. Viti fiskal i kompanisë është me 31 dhjetor 2019 dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës së auditimit për fushat e mëposhtme. Përmbledhja e punës së kryer të auditimit është përshkruar më poshtë:

(a) Pasuritë e mbajtura për shitje

Për shkak të mbylljes së njëres nga fabrikat e Thumanës, prona dhe pasuritë shoqëruese janë klasifikuar si pasuri të mbajtura për shitje në pasqyrat financiare. Është bërë një regjistrim manual në ditar nga drejtori financiar për të riklasifikuar këto pasuri nga pasuritë joqarkulluese në pasuri joqarkulluese dhe për të korrigjuar këto pasuri për dëmtim në vlerë dhe për të rikthyer zhvlerësimin e ngarkuar nga data kur janë plotësuar kushtet për tu njohur si pasuri të mbajtura për shitje. Drejtori financiar kishte pyetur seniorin e auditimit që të kontrolloj këtë regjistrim para se ta bënte në ditar për shkak se nuk kishte ndonjë punonjës tjetër me njohuri relevante në kompani për të bërë këtë. Mbyllja e planifikuar me fabrikën ishte diskutuar me menaxhmentin. Një shënim i shkurtër ishte përfshirë në letrat e punës së auditimit në të cilin shkruhej se sipas mendimit të menaxhmentit, trajtimi si pasuri të mbajtura për shitje është i saktë. Regjistrimi në ditar është kontrolluar për saktësi matematikore nga një anëtar tjetër i ekipit të auditimit, dhe shumat përputhen me regjistrin e pasurive joqarkulluese. (9 pikë)

(b) Shpenzimet kapitale

Gjatë auditimit të shpenzimeve kapitale të kompanisë, ekipi i auditimit përzgjodhi transaksionet materiale për të testuar dhe gjeti se kontrollet e brendshme kyçe mbi shpenzimet kapitale nuk ishin duke operuar me efektivitet. Nuk ishte marr autorizimi për një porosi të disa automjeteve dhe nuk kishte ndarje të duhur të detyrave mbi inicimin dhe procesimin e transaksioneve. Ekipi i auditimit kishte shënuar këto mangësi në kontrolle dhe kishte azhurnuar dosjen e përhershme të auditimit për të reflektuar këto mangësi. Puna e përfunduar e auditimit në këtë porosi ishte që të përputhet blerja e automjeteve me faturën e blerjes me pagesën përmes bankës. Pjesa tjetër e punës së auditimit për shpenzimet kapitale ishte përfunduar sipas programit të paraparë të auditimit. (7 pikë)

(c) Shpenzimet e pagave

Funksioni i pagave është kontraktuar te Gjoni Shpk, një organizatë për shërbime e cila proceson të gjitha shpenzimet e pagave të Thumanës. Shpenzimet e pagave të njohura në pasqyrat financiare të kompanisë janë ndjekur deri te raportet e fundvitit të lëshuara nga Gjoni Shpk. Ekipi i auditimit nuk ka kontakt direkt me Gjoni Shpk pasi që raportet e fundvitit ishin dërguar nga Gjoni Shpk te drejtori financiar i Thumana i cili i kishte përcjellur ato te ekipi i auditimit. Thumana punëson disa punëtorë me afat të caktuar të cilët paguhen me para të gatshme në fund të çdo muaji dhe nuk përfshihen në listën e zakonshme të pagave me punëtorët tjerë. Ekipi i auditimit ka përputhur pagesat me para me regjistrin e parasë së gatshme dhe ka konsideruar se shumat janë jomateriale. (9 pikë)

Kërkohet: lidhur me secilën nga çështjet e mësipërme:

- (i) Komentoni mbi mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e dëshmive të përfuara të auditimit;
- (ii) Rekomandoni procedurat e mëtejshme të auditimit që duhet të kryhen nga auditori; dhe
- (iii) Shpjegoni çështjet të cilat duhet të përfshihen në një raport (letër të menaxhmentit) në pajtueshmëri me SNA 265 Komunikimi i Mangësive në Kontrollet e Brendshme për personat e ngarkuar me qeverisjen dhe menaxhmentin.

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Pasuritë e mbajtura për shitje

(i) Dëshmitë e auditimit

Dëshmitë nuk duket se janë të mjaftueshme për të arritur një konkluzion lidhur me përshtatshmërinë e klasifikimit të PJQ dhe detyrimet përkatëse si pasuri të mbajtura për shitje. Diskutimi me menxhmentin për mënyrën e trajtimit është relevant mirëpo nuk duhet të pranohet pa dëshmi tjera vërtetuese përmes procedurave shtesë të auditimit. Pra, nuk është e mjaftueshme vetëm të përfshihet konkluzioni i menxhmentit në dosjen e auditimit pa u vërtetuar, psh fabrika mund të klasifikohet si pasuri e mbajtur për shitje vetëm nëse është në dispozicion për tu shitur menjëherë. Sa i përket regjistrimit manual, kontrollimi i saktësisë matematikore është relevant mirëpo nuk është dëshmi e mjaftueshme. Duhet të grumbullohet dëshmi e mëtutjeshme e auditimit për të arritur në përfundim se transaksionet janë trajtuar në pajtueshmëri me SNRF 5 Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera. Psh, rezultatet specifike për fabrikën do të duhet të shpalosen në mënyrë të veçantë si operacione të ndërprera në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në pasqyrën e rrjedhës së parasë. Nuk duket se është përfutur dëshmi e auditimit lidhur me këto çështje.

(ii) Procedurat e mëtejshme të auditimit

- Rishikimi i procesverbaleve të takimit të bordit për të konfirmuar se është aprovuar shitja e fabrikës dhe konfirmimi i datës së aprovimit
- Përftimi i korrespondencave me agjentët e patundshmërive për të konfirmuar se fabrika është duke u shitur
- Përftimi i konfirmimit, psh, duke rishikuar planet e prodhimit, regjistrat e lëvizjes së stokeve dhe regjistrin e pagave, se prodhimi në fabrikë është ndërprerë prandaj është në dispozicion për shitje të menjëhershme.
- Pëdorimi i ekspertit për të konfirmuar vlerën e drejtë të pronës dhe të përputhet shifra që është përdorur në llogaritjen e dëmtimit.
- Duke përdorur pasqyrat menaxheriale, përcato nëse fabrikë është linjë e veçantë e biznesit dhe nëse po duhet të shpaloset si operacion i ndërprerë.

(iii) Raporti ndaj personave të ngarkuar me qeverisjen

SNA 265 kërkon nga auditori të komunikojë mangësitë domethënëse në kontrolle të brendshme të personat e ngarkuar me qeverisjen dhe menaxhmenti. Për të vlerësuar nëse një mangësi në kontrolle është domethënëse duhet të konsiderohet rëndësia e atij kontrolli në procesin e raportimit financiar. Psh kontrollet mbi procesin e raportimit të fundvitit dhe regjistrimin e manual të transaksioneve në ditar janë të rëndësishme sepse kanë të bëjnë me transaksione jorutinore të cilat duhet të autorizohen.

Raporti duhet të rekomandoj që të themelohen kontrolle për regjistrimet manuale në ditar për të siguruar saktësinë dhe vlefshmërinë.

Përveç kësaj, drejtori financiar nuk duhet të kërkoj nga ekipi i auditimit të kontrolloj shifrat e tij pasi që kjo mund të perceptohet si kërcënim ndaj pavarësisë për shkak të vetërishikimit. Kjo është çështje që duhet të raportohet edhe te komiteti i auditimit që të ndërmerren hapat e duhur për të siguruar se angazhohen persona me njohuri të duhur për ofruar trajnim në raportim financiar për personelin ekzistues.

(b) Shpenzimet kapitale

(i) Puna e kryer e auditimit

Puna e auditimit ka zbuluar se kontrollet e brendshme nuk kanë funksionuar dhe kjo duhet të ketë çuar në një testim më të gjerë të shpenzimeve kapitale, në vend se programi i auditimit të përfundojë ashtu siç ishte planifikuar. Në përgjithësi, ekipi i auditimit duhet të zgjerojë testimin e auditimit mbi shpenzimet kapitale, për shembull, duke shtrirë testimin e mostrave dhe duke zvogëluar nivelin e materialitetit të përdorur në testet e auditimit. Ekipi i auditimit gjithashtu duhet të hetojë pse kontrollet nuk funksionojnë, duke marrë parasysh nëse po injorohen me

paramendim ose anashkalohen, nëse presioni në kohë ose mungesa e burimeve po i vështirëson funksionimet e kontrolleve, ose nëse ekziston dyshimi për bashkëpunim dhe mashtrim të mundshëm. Procedurat për blerjen e automjeteve nuk duket se mbulojnë të gjitha pohimet përkatëse, për shembull, nuk ka asgjë për të konfirmuar që Thumana ka zhvlerësuar saktë automjetet ose që ato janë në të vërtetë prone e kompanisë dhe që përdoren nga kompania, apo edhe që ato ekzistojnë.

(ii) Procedurat e mëtutjeshme të auditimit

- Merrni dokumentet e sigurimit për të konfirmuar se Thumana paguan sigurimin përkatës për automjetet.
- Verifikoni fizikisht automjetet dhe konfirmoni që ato përdoren nga punonjësit në biznesin e ndërmarrjes.
- Merrni regjistrin e kilometrave / librezën e automjeteve dhe dokumentet e tjera përkatëse të pronësisë, siç janë ato të lëshuara nga organi i regjistrimit të automjeteve, për të konfirmuar të drejtën e Thumana për të njohur automjetet.
- Gjurmoni automjetet në regjistrin e pasurive joqakulluese të kompanisë.
- Rillogaritni zhvlerësimin që duhej të ishte ngarkuar në automjete dhe përputhni atë me pasqyrën e të ardhurave për vitin.

(iii) Raport për personat e ngarkuar me qeverisje

Auditori duhet t'u raportojë atyre që janë përgjegjës për qeverisjen se duket se ka mangësi në kontrollet e brendshme. Ndërsa gjetjet e ekipit të auditimit nuk tregojnë se po ndodh një mashtrim, mungesa e ndarjes së detyrave dhe mos marrja e autorizimit të duhur e bën të lehtë përvetësimin e pasurive dhe krijon një rrezik të rëndësishëm mashtrimi. Firma e auditimit duhet të shpjegojë implikimet e mangësive të kontrollit tek menaxhmenti dhe të rekomandojë përmirësime. Për shembull, autorizimi duhet të jetë parakusht për çdo porosi mbi një shumë të caktuar monetare. Thumana gjithashtu duhet të inkurajohet të përmirësojë mjedisin e kontrollit, për shembull, nga trainimi i stafit për rëndësinë e kontrolleve dhe vendosjen e një toni të duhur në krye, në mënyrë që të mos ketë asnjë tolerancë që kontrollet të injorohen ose të anashkalohen me qëllim.

(c) Pagesa e pagave

(i) Puna e auditimit

Puna e auditimit në lidhje me listën e pagave duhet të jetë shumë më e hollësishme; thjesht dakordimi i shumave me raportet e lëshuara nga Gjoni nuk ofron dëshmi mbi plotësinë, saktësinë ose vlefshmërinë e shifrave të pagave të njohura në pasqyrat financiare. Ekipi i auditimit duket se është mbështetur në raportet e fundvitit të Gjoni si të sakta dhe kërkesat e SNA 402 Konsideratat e Auditimit në lidhje me një entitet që përdor një organizatë për shërbime nuk duket se janë ndjekur. Ekipi i auditimit duhet të përftojë siguri për kontrollet që Gjoni ka zbatuar në mënyrë që të vlerësojë rrezikun e anomalisë materiale në shifrat e pagave dhe t'i përgjigjet rrezikut me procedurat e duhura të auditimit. Kontrollet të cilat Thuman përdor për të verifikuar informacionin e marrë nga Gjoni gjithashtu duhet të kuptohen. Me lejen e Thuman, ekipi i auditimit duhet të kontaktojë Gjoni me qëllim të marrjes së më shumë informacioneve që mund të përdoren për të vlerësuar se si është procesuar lista e pagave dhe kontrollet që janë në funksion. Kontrollet për pagat duhet të dokumentohen dhe testohen. Rekomandohet që të bëhen procedura të tjera thelbësore për të siguruar një gamë më të gjerë të dëshmive mbi shpenzimet e pagave të

njohura në pasqyrat financiare. Në lidhje me punonjësit e rastit, fakti që shuma e përfshirë është jomateriale do të thotë që ekipi i auditimit nuk ka nevojë të kryejë ndonjë procedurë të mëtejshme të detajuar të auditimit pasi nuk ekziston rreziku i anomalisë materiale. Sidoqoftë, pasi ekziston një rrezik mbi plotësinë e këtyre kostove, duhet të diskutohet me menaxhmentin dhe të dokumentohen kontrollet e vendosura në këtë fushë.

(ii) Procedurat e mëtutjeshme të auditimit

- Rishikoni marrëveshjen e shërbimit midis Thuman dhe Gjoni për të kuptuar punën e saktë që kryhet nga Gjoni si një organizatë shërbimi.
- Lexoni të gjitha raportet e bëra nga Gjoni gjatë vitit për të identifikuar rreziqet e anomalisë në shifrat e pagave.
- Diskutoni dhe dokumentoni kontrollet përkatëse të vendosura në Thuman mbi informacionin e marrë nga Gjoni dhe menaxhimin e punonjësve të rastit, dhe kryeni testet e kontrolleve mbi bazën e mostrës.
- Vlera e tatimeve të papaguara për punëtorët e rastit duhet të matet me rillogaritjet e shumave të duhura.
- Lexoni çdo manual të përdoruesit ose përmbledhje të sistemeve për të vlerësuar efektivitetin e kontrolleve të vendosura në përpunimin e listës së pagave.
- Nëse është e nevojshme, merrni një raport të tipit 1 ose tip 2 nga Gjoni për të marrë siguri të mëtutjeshme mbi kontrollet që ka organizata e shërbimit.
- Kryeni procedurat e pavarura analitike mbi listën e pagave, duke përgatitur një pritje të auditorit për shifrat e pagave dhe duke e krahasuar me shifrat e njohura në pasqyrat financiare dhe duke diskutuar çdo variancë me menaxhmentin.
- Kryeni testet e detajeve duke zgjedhur një mostër nga të dhënat e pagave dhe duke i dakorduar shumat me fletëpagesa dhe me të dhënat nga burimet njerëzore.

(iii) Raport për personat e ngarkuar me qeverisje

Fakti që punonjësit e rastësishëm janë duke u paguar nga paratë e imëta pa u futur në listën e pagave të kompanisë tregon që Thuman mund të mos jetë në përputhje me rregulloret përkatëse, për shembull, që tatimet e duhura të pagave nuk paguhen. Megjithë shumat e përfshira janë jomateriale, mosrespektimi i mundshëm duhet t'u raportohet personave që janë përgjegjës për qeverisje, së bashku me një rekomandim që të gjithë punonjësit, qoftë të rastësishëm apo jo, duhet të përpunohen përmes sistemit të pagave të kompanisë. Mund të ketë pasoja për pasqyrat financiare nëse gjobat ose ndëshkimet shqiptohen nga organet tatimore në lidhje me mospërputhjen me ligjet tatimore.

Detyra 3

Ju jeni menaxher i auditimit të kompanisë klient OsaM, një prodhues dhe shitës me pakicë i stolive të çmueshme. Auditimi për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2019 është afër përfundimit dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës. Pasqyrat financiare draft paraqesin pasuri gjithsej €1,919 milion (2016 – €1,889 milion), të hyra prej €1,052 milion (2016 – €997 milion) dhe fitim para tatimit prej €107 milion (2016 – €110 milion). Janë tre çështje që duhet të rishikohen:

(a) Kosto e stokeve

Kosto e stokeve përfshinë të gjitha kostot e blerjes dhe koston e konvertimit të lëndës së parë në mallrat e gatshme. Kostot e konvertimit përfshijnë punën direkte dhe shpërndarjen e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit. Kosto e punës direkte llogariten bazuar në kohën mesatare të prodhimit për njësi të stokeve, që vlerësohet nga menaxheri i prodhimit, shumëzuar me koston e vlerësuar të punës për orë, e cila llogaritet duke përdorur pagat e parashikuara vjetore të prodhimit pjesuar me orët e parashikuara vjetore të prodhimit. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit janë të gjitha fikse dhe shpërndahen bazuar në njësitë e parashikuara vjetore të prodhimit. Në fund të vitit stoqet kishin vlerë prej €21 milion (2016 – €20 milion). (9 pikë)

(b) Dëmtimi

Në fund të vitit menaxhmenti kishte bërë rishikimin për dëmtim të dyqaneve të pakicës, të cilat janë individualisht njësi të gjenerimit të parasë për qëllim të kryerjes së rishikimit për dëmtim. Për derisa shitjet përmes internetit u rriten në mënyrë të shpejtë gjatë vitit, shitjet përmes dyqaneve kishin rënie, që rezultoj me nevojën për rishikim të vlerës së tyre. Me 31 dhjetor 2019 vlera bartëse e pasurive që i atribuohen direkt dyqaneve me pakicë ishte €137 milion, kjo përfshin pasuritë e trupëzuara dhe zërin e mirë. Gjatë vitit menaxhmenti pranoi një numër të ofertave nga palët e interesura për të mblerë dyqanet me pakicë me një vlerë €125 milion. Ata po ashtu vlerësuan koston e shitjes në €1.5 milion, bazuar në përvojën e tyre të blerjeve dhe shitjeve të korporatave. Menaxhmenti vlerësoj vlerën në përdorim të këtyre pasurive në €128 milion. Kjo bazohej në rrjedhat historike të parasë së gatshme që i atribuohen dyqaneve dhe me inflacion prej 1% vjetor. Kjo, thanë atë, reflekton performancën e dobët të dyqaneve. Si rrjedhojë, dyqanet u dëmtuan me €9 milion për ti sjellur ato në vlerën e rikuperueshme prej €128 milion. Dëmtimi u alokua kundrejt pasurive të trupëzuara (të dyqaneve) në bazë proporcionale, bazuar në vlerën origjinale bartëse të secilës njësi të pasurisë. (8 pikë)

(c) Provizionet për garancion

Secilin vit menaxhmenti e njeh një provision për stolitë e kthyer që kishin garancion. Ky provision bazohet në nivelin e vlerësuar të kthimeve për secilin lloj të produktit (unaza, vathë, qafore, etj) dhe llogaritet në bazë vjetore nga drejtori i shitjes. Tabela e detajuar e provizioneve aktuale siç është nxjerrë nga shënimet e pasqyrave financiare është paraqitur më poshtë: (8 pikë)

	€ milion
Me 1 janar 2019	11.5
Provizionet e ngarkuara gjatë vitit	0.5
Provizionet e shfrytëzuara gjatë vitit	(1.9)
Provizionet e pashfrytëzuara (revers)	(3.1)
Me 31 dhjetor 2019	7.0

Kërkohet:

Komentoni mbi çështjet që duhet konsideruar dhe shpjegoni dëshmitë e auditimit që pritet të gjeni në dosjen e auditimit për secilin rast më sipër.

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja

(a) Kostoja e stokeve

Çështjet

Materialiteti

Kostot e stokeve përfaqësojnë 1.1% të totalit të pasurive dhe 19.6% të fitimit. Stoket pra janë materiale si për pasqyrën e pozicionit financiar ashtu edhe për pasqyrën e të ardhurave.

Rreziku i anomalisë materiale

Llogaritja e kostonë së stokeve është komplekse. Ky kompleksitet rrit rrezikun e gabimit në llogaritje, gjë që rrit rrezikun e anomalisë. Llogaritja gjithashtu i nënshtrohet një numri vlerësimesh; koha mesatare e prodhimit për njësi, kostoja vjetore e parashikuar e pagës, orët e planifikuara të prodhimit dhe njësitë parashikuese të prodhimit janë të gjitha vlerësime. Këto vlerësime rrisin rrezikun e gabimit dhe manipulimit të llogaritjes që i përshtaten paragjykitimit të menaxhmentit. Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe subjektivitetin e përfshirë në llogaritje, ekziston një rrezik i konsiderueshëm që kostoja e stokeve të mund të ketë anomali.

Dëshmitë që pritet të jenë në dosje:

- Dokumentim i sistemit për marrjen e të dhënave të përdorura në llogaritjen e kostonë. Kjo duhet të identifikojë kontrollet kryesore që funksionojnë në këtë sistem dhe duhet të ketë dëshmi në dosje që këto kontrolle janë testuar në mënyrë të duhur.
- Një kopje e përmbledhjes së kostove të blerjes së stokeve. Një mostër e kostove të blerjes, përfshirë kostot shtesë të transportit dhe trajtimit, duhej të ishte konfirmuar përmes inspektimit të faturave origjinale të blerjeve, kopjet e të cilave gjithashtu duhet të jenë në dosje.
- Dokumentim i rezultateve të një diskutimi me menaxherin e prodhimit për të përcaktuar se si ata vlerësojnë kohën mesatare të prodhimit për njësi të stokeve. Çfardo llogaritje e përmendur nga menaxhmenti duhet të ishte rikryer nga ekipi i auditimit për të konfirmuar saktësinë e tyre matematikore dhe për ta dakorduar me dokumentimin vërtetues.
- Një kopje e llogaritjes së kostonë vjetore të parashikuar të pagës. Nivelet fillestare të personelit duhet të ishin konfirmuar përmes inspektimit të regjistrave aktual të burimeve njerëzore dhe për një mostër të stafit paga e tyre fillestare duhej të ishte konfirmuar përmes inspektimit të regjistrave të pagave.
- Rritjet e pagave të parashikuara duhej të ishin rënë dakord me konfirmimin e fundvitit të lëshuar nga burimet njerëzore ose procesverbalet e mbledhjeve të bordit që kanë aprovuar ngritje të pagave.
- Dokumentimi i rezultateve të diskutimit me menaxhmentin lidhur me mënyrën se si është bërë parashikimi dhe kush është në fund të fundit përgjegjës për rishikimin dhe miratimin e parashikimit.
- Një kopje e llogaritjes së njësitë të parashikimit të prodhimit. Kjo duhej të ishte rishikuar në mënyrë analitike në krahasim me nivelet e prodhimit të vitit të kaluar. Aty ku ka ndryshime të konsiderueshme, duhen kërkuar shpjegime nga menaxhmenti.
- Një kopje e llogaritjes së shpenzimeve të përgjithshme të parashikuara të prodhimit. Kjo duhet të ishte rishikuar në mënyrë analitike nga kategoria e sipërme në lidhje me vitin e kaluar për të identifikuar ndonjë variancë të rëndësishme. Dëshmitë vërtetuese, të tilla si marrëveshjet e qirasë dhe shërbimeve, duhet të ishin marrë po ashtu.
- Duhet të ketë dëshmi në të gjitha tabelat e menaxhmentit që shifrat janë rikalkuluar nga ekipi i auditimit për të konfirmuar saktësinë matematikore të llogaritjeve të menaxhmentit.

(b) Dëmtimi

Çështjet

Materialiteti

Dëmtimi prej 9 milion € përfaqëson 0.47% të totalit të pasurive dhe 8.41% të fitimit. Ndërsa nuk është materiale për pasqyrën e pozicionit financiar, është materiale për pasqyrën e të ardhurave.

Llogaritja e vlerës së rikuperueshme

Vlera e drejtë e shitoreve me pakicë, kostot e shitjes dhe vlera në përdorim janë të gjitha vlerësime të menaxhmentit. Kjo rrit rrezikun e anomalisë materiale përmes gabimit dhe manipulimit të shifrave të raportuara nga menaxhmenti. Në veçanti, ndërsa vlerësimi për vlerën e drejtë duket të ketë një bazë të arsyeshme, vlerësimi i vlerës në përdorim duket të jetë shumë themelor. Supozimi se rrjedhat e parasë që i atribuohen tërë divizionit të shitjes me pakicë që do të rritet me 1% në vit është shumë e thjeshtë dhe duket se nuk ka justifikim tregtar. Ka gjasë që çdo dyqan t'i nënshtrohet ndryshimeve rajonale të rritjes dhe ritmet e rritjes gjithashtu do të jenë subjekt i luhatjeve vjetore bazuar në variblat ekonomike. Nuk ka asnjë arsytim se përse është zgjedhur rritja 1% për të përfaqësuar 'performancën e dobët', të paktën kjo duhet të krahasohet me parashikime më të përhapura dhe të besueshme të rritjes, p.sh. parashikimet kombëtare të rritjes ekonomike.

Alokimi i dëmtimit

Dëmtimi është shpërndarë ndaj të gjitha pasurive të trupëzuara në njësinë gjeneruese të parave të gatshme. Kjo është e pasaktë; si njësi gjeneruese e parave, dëmtimi së pari duhet të shpërndahet ndaj çdo emri të mirë në lidhje me njësinë gjeneruese të parave, në përputhje me SNK 36 Dëmtimi i Pasurive. Pastaj duhet të shpërndahet ndaj pasurive të mbetura në baza proporcionale duke pasur parasysh që një pasuri nuk duhet të dëmtohet nën vlerën e drejtë minus kostot e shitjes apo vlerës së saj të përdorimit cilado që është më e lartë

Dëshmitë që pritet të jenë në dosje:

- Kopjet e ofertave të marra për blerjen e shitoreve me pakicë, duke konfirmuar shumat e ofruara. Këto duhet të ishin përdorur për të rillogaritur mesataren e përdorur për vlerësimin e vlerës së drejtë.
- Dokumentimi i pyetjeve me menaxhmentin në lidhje me mënyrën se si ata vlerësuan kostot e shitjes dhe çfarë përvoje kanë pasur me shitjen e operacioneve të ngjashme.
- Një kopje e rrjedhës së parasë së parashikuar që i atribuohet shitoreve. Kjo duhet të përmbajë dëshmi të rprocedurave analitike në krahasim me vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 për të konfirmuar saktësinë e rrjedhës bazë të parave.
- Duhet të ketë dëshmi të rillogaritjes së rrjedhës së ardhshme të parave duke përdorur vlerësimet e rritjes prej 1% të menaxhmentit për të konfirmuar saktësinë matematikore të llogaritjes së menaxhmentit.
- Duhet të ketë dëshmi të rillogaritjes së vlerës në përdorim duke përdorur një gamë të normave të rritjes për të vlerësuar ndjeshmërinë e llogaritjeve të menaxhmentit ndaj variablave ekonomike. Dallimet midis këtyre vlerësimeve dhe vlerësimit të menaxhmentit duhet të ishin rishikuar për të vlerësuar gjasat e një nën ose mbi-vlerësimi material.
- Dëshmitë e procedurave analitike të performancës nga shitja me pakicë ose zona gjeografike e operacioneve, që janë referuar shitjeve dhe regjistrave të rrjedhës së parave, për të konfirmuar nëse normat e rritjes janë konsistente në të gjithë markën ose nëse ka varianca.
- Dokumentim i pyetjeve me menaxhmentin në lidhje me pritjet e tyre për dyqane specifike me pakicë ose fushat e operacioneve dhe nëse ka ndonjë çështje specifike për të cilën ata janë të vetëdijshëm për të cilat mund të ndikojnë në performancën rajonale, p.sh. hapja e objekteve të reja tregtare jashtë qytetit ose konkurrentëve që vendosen në të njëjtin vend.
- Një tabelë e zërit të mirë të përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar me analizën e përbërësve të ndryshëm të tij për të vlerësuar nëse ndonjë pjesë i atribuohet shitoreve me pakicë si njësi gjeneruese e parave. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për çdo markë të blerë që mund të shitet përmes dyqaneve me pakicë ose markave të shitjes me pakicë të blera nga kompania.

- Një rillogaritje e alokimit të dëmtimit nga auditori, së pari kundrejt çdo emri të mirë të përcaktuar se mund t'i atribuohet njësisë gjeneruese të parave, pastaj kundrejt vlerës së mbetur të pasurive.
- Kopjet e parashikimeve të mëparshme. Kur performanca e parashikimit të shitjeve me pakicë tejkalon 1% të parashikuar aktualisht nga menaxhmenti, duhet të ketë dëshmi të diskutimit me menaxhmentin për të përcaktuar arsyet e ndryshimit të perspektivës së tyre.

(c) Provizioni i i garancisë

Çështjet

Materialiteti

Provizioni i fundvitit përfaqëson 0.36% të totalit të pasurive dhe 6.54% të fitimit. Prandaj, nuk është material për pasqyrën e pozicionit financiar, por është material për pasqyrën e të ardhurave. Vlerësimet kontabël

Vlerësimi i kthimeve i nënshtrohet qartë subjektivitetit të rëndësishëm. Kjo rrit rrezikun e anomalisë materiale për shkak të gabimit dhe manipulimit. Vlerësimi bëhet nga drejtori i shitjeve; ndërsa ky mund të jetë personi më i mirë për të parashikuar shitjet ai mund të mos jetë personi më i mirë për të parashikuar kthimet. Kthimet ka gjasë të ndikohen më shumë nga cilësia e produktit, prandaj menaxheri i prodhimit ose kontrollit të cilësisë mund të jetë personi më i përshtatshëm për të bërë këtë parashikim. Kjo nënkupton që shumica e parashikimit bazohet në vlerësime të thjeshta, të përgjithshme duke përdorur nivelet e shitjeve sesa në konsiderimin e çështjeve specifike të cilësisë së produktit.

Dëshmitë e mbivlerësimit paraprak

Rreziku i anomalisë rritet nga dëshmitë e mbivlerësimit në të kaluarën. Kthimi i provizioneve të pashfrytëzuara sugjeron që vlerësimet e mëparshme ishin shumë të larta, gjë që tregon pasaktësi në procesin e parashikimit. Kthimi i provizioneve të pashfrytëzuara përfaqëson 2.9% të fitimit, kështu që nuk është individualisht material për pasqyrat financiare. Provizionet e mundshme të kontabilitetit kreativ mund të përdoren për të zbutur fitimet; d.m.th një provizion i bërë në një vit ku fitimet janë të larta dhe të kthyera në vitet e ardhshme (d.m.th. duke i paraqitur përsëri në pasqyrën e të ardhurave) kur objektivat e fitimeve nuk janë përmbushur. Kthimi i provizioneve të pashfrytëzuara në vit ka rritur fitimet e kompanisë me 3.1 milion €. Ndërsa kjo nuk është një svlerë materiale më vete, me mënyrat tjera të kontabilitetit kreativ, siç është manipulimi i vlerësimeve të kostos së stoqeve dhe dëmtimeve, kjo mund të çojë në një mbivlerësim material të fitimeve. Ky duhet të konsiderohet një rrezik i veçantë për kompaninë pasi fitimet e tyre kanë rënë gjatë vitit, megjithëse ka pasur rritje prej 5.5% të të ardhurave gjatë vitit. Rënia e performancës ofron një nxitje të shtuar për menaxhmentin për të adoptuar praktika manipuluese të kontabilitetit për të ndihmuar në arritjen e objektivave dhe zbutje të fitimeve.

Dëshmitë që pritet të jenë në dosje:

- Kopjet e kushteve të shitjes të ofruara për klientët për të konfirmuar kohëzgjatjen e periudhës së garancisë.
- Shënime të diskutimeve me drejtorin e shitjeve që konfirmojnë bazën e llogaritjes së parashikimit të kthimeve. Këto duhet të përmbajnë në mënyrë specifike çdo normë të përgjithshme të kthimit të aplikuar në llogaritje dhe çdo çështje specifike që drejtori ka marrë parasysh, siç janë mosfunksionimet e njohura ose cilësia e dobët e produktit.
- Një kopje e llogaritjes së provizionit. Komponentët e llogaritjes duhet rillogaritur dhe rishikuar në mënyrë analitike në krahasim me vitet e kaluara dhe çdo luhatje duhet të ishte vërtetuar me dëshmitë mbështetëse.
- Një tabelë për të analizuar kthimet totale të marra pas fundit të vitit. Një mostër e këtyre kthimeve duhet të ishte krahasuar me faturën origjinale të shitjeve, duke konfirmuar datën në të cilën mallrat u shitën për herë të parë.
- Kjo tabelë gjithashtu duhet të ishte shqyrtuar në mënyrë analitike në krahasim me të njëjtën periudhë të viteve të kaluara për të identifikuar nëse nivelet e kthimit ishin

konsistente. Çfardo luhatje e rëndësishme duhet të ishte vërtetuar me dëshmi ose hetim të menaxhmentit.

- Një tabelë që konfirmon llogaritjen e provizioneve totale të pashfrytëzuara të kthyer gjatë vitit. Këto duhet të shoqërohen me shënimet e takimit me menaxhmentin që identifikojnë arsyet pse nuk ishin të nevojshme këto provizione dhe, kur është e mundur, me çfarë periudhe kohore lidhen provizionet fillestare.
- Shënime të një diskutimi me menaxherin e prodhimit ose kontrollit të cilësisë që identifikojnë nëse ka ndonjë problem të njohur me mallrat e shitura gjatë periudhës së garancisë, dhe cilat produkte u prekën. Nëse ekzistojnë çështje të tilla, duhet të ketë dëshmi se këto janë gjurmuar në llogaritjen e provizionit.

Detyra 4

(a) Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Motori Shpk, një kompani që dizajnon dhe prodhon pjesë të motorave. Auditimi i pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 është afër përfundimit dhe ju jeni duke i rishikuar letrat e punës të seksionit të hipotezës së vijimësisë në dosjen e auditimit. Pasqyrat financiare paraqesin një humbje prej €500,000 (2018 – fitim prej €760,000) dhe gjithsej pasuri prej €13.8 milion (2018 - €14.4 milion).

Seniori i auditimit ka përgatitur një shënim për ju:

'Kam kryer procedura analitike në pasqyrat financiare. Koeficienti qarkullues është 0.8 (2018 – 1.2), koeficienti i shpejtësisë është 0.5 (2018 – 1.6). Pasqyrat menaxheriale të fundit tregojnë se këto koeficient janë përkeqësuar edhe më shumë që nga fundi i vitit dhe tani kompania ka një saldo të parasë prej vetëm €25,000. Burimi ka një kredi afatgjatë të papaguar në vlerë €80,000 me disa kushte të cilat theksojnë se nëse koeficienti qarkullues bie nën 0.75, kredia mund të ndërpritet menjëherë nga banka.'

Ju po ashtu jeni në dijeni se produktet më të shitura të Burimi Shpk teknikisht janë bërë të papërdorshme/jasht-mode gjatë vitit 2015 pasi që konsumatorët tani janë orientuar në pjesë motori që janë më ekologjike. Historikisht këto produkte kanë gjeneruar 45% të të hyrave të kompanisë. Si përgjigje ndaj preferencave të konsumatorëve, kompania ka shpenzuar €1.3 milion në dizajnimin e produktit të ri që është më ekologjik dhe produkti pritet të lansohet në korrik 2020 dhe do të reklamohet si produktet miqësor ndaj ambientit.

Është përgatitur një parashikim i parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe bazuar në supozimet e bëra, sadoja përfundimtare e parasë do të rritet në €220,000. Supozimet përfshijnë:

1. Lansimi i suksesshëm i produktit të ri
2. Shitja e makinerisë që ishte përdorur për të prodhuar produktin e vjetër, që do të gjeneron të hyra në para prej €50,000, kjo do të ndodhë në qershor 2020
3. Një zvogëlim në koston e pagave prej 15% i shkaktuar nga ndërprerja e kontratave të punëtorëve për vijën e prodhimit të produktit të vjetër
4. Pranimi i një granti qeveritar prej €30,000 nga ministria që përkrah zhvillimin e produkteve ekologjike, që panifikohet të merret në korrik 2020.

Kërkohet:

- (i) **Identifikoni dhe shpjegoni çështjet që hedhin dyshim mbi aftësinë e kompanisë Burimi të vazhdojë operimin sipas hipotezës së vijimësisë. (6 pikë)**
- (ii) **Shpjegoni dëshmitë e auditimit që prisni të gjeni në dosjen e auditimi lidhur me parashikimin e parasë. (8 pikë)**

(b) Pas përfundimit të rishikimit të dosjes së auditimit, ju keni arritur në përfundim se përdorimi i hipotezës së vijimësisë është i përshtatshëm, por ka dyshime domethënëse në aftësinë e kompanisë të vijoje sipas hipotezës së vijimësisë. Ju keni këshilluar komitetin e auditimit të kompanisë se nevojitet një shënim në pasqyra financiare për të shpjeguar dyshimin domethënës për hipotezën e vijimësisë. Komiteti i auditimit është duke ngurrar të përfshijë një shënim të tillë për shkak të frikës se kjo do të shfaqte problemet e kompanisë dhe do të shkaktonte vështirësi tjera financiare, por ishin pajtuar se një shënim i shkurt do të përfshihej.

Kërkohet:

Sa i përket shënimit mbi hipotezën e vijimësisë që do të përfshihet në pasqyrat financiare të Burimi Shpk, diskutoni implikimet në raportin e auditimit dhe paraqitni veprimet e mëtutjeshme që duhet të kryhen nga auditori. (6 pikë)

(Gjithsej 20 pikë)

Zgjidhja

(a) (i) Performanca

Rënia nga fitimi i mirë në një humbje prej €0.5 milion. Kjo duket se është rezultat nga dalja jashtë mode e produktit kryesor dhe humbja e 45% të të hyrave.

Duket se profitabiliteti do të bie edhe më shumë në vitet e ardhshme si efekt i mosshitjes së produktit kryesor.

Edhe pse kompania ka zëvendësimin, çfardo produkti i ri do të merr kohë për të fituar pjesën e duhur të tregut dhe nu ka shumë mundësi që ky trend i rënies do të kthehet në të kundërtën shumë shpejtë.

Likuiditeti

Përkeqësimi i koeficientëve të qarkullimit dhe të shpejtësisë trgojnë për një rënie të vazhdueshme të likuiditetit. Me detyrimet qarkulluese që janë më të mëdha se pasuritë qarkulluese kompania nuk do të ketë mundësi të paguaj borxhet kur ju vjen koha. Nëse nuk paguhen furnitorët atëherë ata mund të kufizojnë furnizimin.

Përveç kësaj, nëse ka stoqe të produktit të vjetër atëherë duhet të njihen humbje nga dëmtimet dhe kështu koeficientët do të zbresin edhe më shumë.

Pozita e parasë

Saldoja e parasë së gatshme të kompanisë prej €25,000 është shumë e ulët që përfaqëson vetëm 0.2% të pasurive totale. Ka pak mundësi që kompania të mbijetojë me aq pak para. Nuk dihet nëse kompania ka mbiterheqe që mund të ndihmonte të mbijetonte për së paku edhe disa kohë.

Kushtet e kredisë

Pasi që koeficientët e qarkullimit dhe shpejtësisë kanë rënë në krahasim me vitin e kaluar, ka mundësi që kushtet e kredisë tashmë janë shkelur. Nëse tërhiqet kredia nga banka, paraja ekzistuese nuk do të jetë e mjaftueshme për të paguar atë.

Kompania mund të duhet të shes pasuri tjera për të paguar kredinë.

Lansimi i motorit të ri

Mungesa e kapitalit qarkullues të kompanisë do të bënte të vështirë zhvillimin e produktit të rid he lansimin e tij, që do të ishte një rrezik i madh për hiptezën e vijimësisë.

(ii) Dëshimitë

- Përputhja e parasë në fillim ne pasqyrat financiare të audituara për të siguruar saktësinë e shifrave
- Rillogaritja e saktësisë matematikore të parashikimit të parasë
- Rishikimi i rezultateve të hulumtimit të tregut për produktin e ri ekologjik, për të siguruar se supozimet lidhur me lansimin e suksesshëm janë të përshtatshme
- Diskutimi i progresit të bërë në zhvillimin e produktit ekologjik me ekspertin teknik, për të vlerësuar mundësinë e lansimit të suksesshëm
- Rishikimi i korrespondencave me konsumatorët për të vlerësuar interesin e tyre për të blerë dhe porositur produktin e ri
- Rishikimi i dokumentacionit të shitjes lidhur me shitjen e pajisjeve për të konfirmuar se €50,000 janë të arritshme
- Inspektimi fizik i fabrikës dhe pajisjeve që do të shiten për të vlerësuar kushtet dhe mundësinë e shitjes

- Rishikimi i paralajmërimeve të bëra për largimin nga puna për të konfirmuar numrin e punonjësve që do të ndikohen
- Testimi përmes mostrës së punonjësve që do të largohen nga puna, duke përputhur shumën që do të paguhet me të dhënat nga burimet njerëzore, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Rishikimi i aplikimit të bërë te qeveria për të konfirmuar shumën e grantit. Konfirmimi i korrespondencave nga qeveria për pranimin e €30,000.
- Pajtueshmëri e rrjedhës së parasë nëse është konsistente me fitimin dhe parashikimet tjera të përgatitura nga menaxhmenti
- Konfirmimi se supozimet e bëra në përgatitjen e parashikimit të parasë janë konsistente me njohurinë e auditorit për biznesin dhe qëllimet e menaxhmentit
- Krahësimi i parashikimit të parasë së gatshme për periudhën e ardhshme me pasqyrat menaxheriale, për të siguruar saktësinë e parashikimit
- Procedurat analitike të përfshira në parashikimin e rrjedhës së parasë, psh, kategoritë e shpenzimeve dhe hulumtimi i zërave që mund të jenë shmangur

(b) SNK 1 Prezentimi i pasqyrave financiare kërkon shpalosje për situatat kur ka dyshime domethënëse mbi hipotezën e vijimësisë. Një shënim i shkurtër ka gjasë të jetë i pamjaftueshëm pasi që shënimi duhet të përshkruaj arsyet për dyshimin së bashku me planet e menaxhmentit për të dalur nga kriza.

Shpalosja e mjaftueshme

Në këtë rast është në pajtueshmëri me SNK 1 prandaj pasqyrat financiare nuk përmbajën anomali material. Në këtë rast auditori do të përfshij një paragraph për theksimin e çështjes por opinion nuk do të ndryshojë.

Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.

Shpalosja e pamjaftueshme

Në këtë rast ka anomal materiale sa i përket SNK 1. Pyetja për auditorin është nëse anomalia është vetëm materiale apo edhe përhapëse. Në rastin e parë auditori duhet të jep opinion me rezervë ndërsa në rastin e dytë të jep opinion kundër.

Në të dy rastet duhet të përfshihet një paragraf i bazës së opinionit me rezervë/kundër dhe do të përshkruaj arsyet e modifikimit të opinionit. Ky paragraf vendoset pas paragrafit të opinionit. Auditori duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen lidhur me modifikimin e raportit të auditorit.